



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:159903

Datë: 04.01.2024

Numri i dokumentit: 05154209

C.nr.197/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. e S. “S.”, të cilën e përfaqëson i autorizuari K. e A. “A.” me avokatët A. P. dhe M. D., me autorizim, kundër të paditurit L. (T.) K., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm G. N., avokat, me objekt kontesti Rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit: 1,451.50 €uro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 21.12.2023, në prani të palëve ndërgjyqëse të autorizuarit së paditëses dhe përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, ndërsa me datën 03.01.2024, përpiloi dhe mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses K. e S. “S.”, në tërësi **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri L. (T.) K. nga ..., që paditëses K. e S. “S.” nga ..., t’ia kompensojë-regresoi shumën prej 1,451.50 €uro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar (të dëmtuarit F. A. dhe F. B.) në aksidentin e datës 28.01.2017, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, po ashtu t’i paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,010. €uro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses K. e S. “S.” nga ..., sa i përket kamatës që kamata të jetë nga data e pagesës, në tërësi **si e pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësja, nëpërmes të autorizuarit të saj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit, paditëses t’ia paguajë shumën prej 1,451.50 €uro, me kamatë ligjore prej 8%, që nga data e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës. Ka shtuar se nuk është kontestuese se me dt.28.01.2017, rreth orës 20:00, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit me fajin e shoferit i cili ka pasur policë të sigurimit tek paditësja. Mirëpo, duke u bazuar ne raportin e aksidentit është vërtetuar se vozitësi L. K. e drejtonte automjetin tij pa pasur patentë shofer te vlefshëm mbi bazën e kësaj duke u bazuar në

ligjin e LSDA-së dhe nenit 14 par.1 pika 1.2, i njëjti e ka humbur mbulesën siguroese dhe paditësja mbi bazën kësaj ka kompensuar palët e dëmtuara në këtë aksident në procedurë jashtë gjyqësore e cila vërtetohet ne baze te provave te dozuar me padi, andaj mbi bazën e kësaj lind e drejta për te kërkuar regresimin e borxhit. Ndërsa lidhur me pretendimet për parashkrim i njëjti pretendim nuk qëndron pasi afati ka filluar të rrjedh pas përfundimit të kompensimit për palën e dëmtuar andaj padia është paraqitur brenda afatit ligjor.

Andaj, nga të theksuarat gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse ta aprovoj në tërësi, duke i shtuar edhe kërkesën për shpenzime të procedurës gjyqësore në vlerë të tërësishtme shumë prej 1,114.00 Euro, dhe atë për padi shume prej 104 Euro, për tri seanca shumë nga 135.00 Euro, për taksë gjyqësorë shume prej 31.00 Euro, për pagesën ekspertizës shumë prej 150.00 Euro, pagesat për përkthimin e aktvendimit në shumë prej 50.00 Euro, si dhe shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm në shumë prej 374.00 Euro.

I padituri përmes përfaqësuesit të përkohshëm në të përgjigjur në padi, në seancë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshtoi në tërësi padinë dhe kërkesë adinë e paditëses, si për nga baza ashtu edhe për shkak të metave elementare të saj. Ka shtuar se e njëjta është e pabazuar dhe pa prova konkrete të bashkangjitura, sidomos sa i përket legjitimitetit në aspektin objektiv dhe subjektiv. Më tej ka deklaruar se pasi që aksidenti ka ndodhur me dt.28.01.2017, ndërsa padia është paraqitur ne gjykate me dt.23.04.2018, konform nenit 362 par.3 të LMD-së kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës dhe se e paditura nuk ka paraqitur prova sa i përket fajësisë, vendim të formës së prerë apo ekspertizë nga eksperti i komunikacionit rrugor në lidhje me fajësinë. Ka theksuar se në rastin konkret ka shpërputhje me gjendjen faktike. Lidhur me ekspertizën e komunikacionit është deklaruar se nuk kemi vërejtje e as ndonjë kërkesë për sqarim shtesë. Po ashtu ka shtuar se mbetem pranë përgjigjes në padi, pas administrimit të provave në parim e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të nxjerr një aktgjykim meritor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë shumë totale prej 374.00 Euro, 104.00 Euro për përgjigje në padi, ndërsa për dy seanca shumë nga 135.00 Euro për secilën.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: padia e dt.23.04.2018, Raporti i aksidentit nr.2017-AR - 0217 dt.28.01.2017, Konfirmimi i Sigurimit lëshuar nga KS "S." dt.08.02.2017, Llogaria e dëmit total lëshuar nga KS "S." dt.13.02.2017, Vlerësimi i dëmeve jo materiale numër 179A/17, dt.28.02.2017, Urdhër pagesës dëmshpërblim lëshuar nga KS "S." dt.21.04.2017 për F. B., Urdhër pagesë dëmshpërblim lëshuar nga KS "S." dt.27 .04.2017 F. A., Urdhër transfer për pagesën e dëmeve nga llogaria numër ... dt.29.0.2017 Banka Ekonomike, Urdhër transferi për pagesën e dëmeve nga llogaria numër ... dt.17.08.2017, Marrëveshje - Ujdi jashtëgjyqësore me numër të rasti 179/17 dt.28.10.2017 F. B., Ujdi jashtëgjyqësore e lidhur me dt.27.04.2017 në mes të KS "S." dhe të dëmtuarit F. A., Fotot e veturës së dëmtuar, Aktvendim i kësaj gjykate me numër C.nr.197/17 dt.23.09.2022 me të cilin e fton paditësen KS "S." që të bëjë rregullimin e padisë me adresën e saktë të paditurit, Parashtrësë e paditëses me të cilën bënë rregullimin e padisë me adresë të saktë të paditurit dt.04.10.2022 së bashku me Raportin Policor, Kërkesë për verifikimin e adresës për të paditurin L. T. K. drejtuar Policisë së Kosovës, Stacionit Policor në Podujevë dt.13.10.2022, Njoftim i Policisë së Kosovës, Stacionit Policor në Podujeve për

verifikimin e adresës për të paditurin L. T. K. dt.19.10.2022, Kërkesë nga paditësja KS “S. për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit L. T. K. dt.09.11.2022, Procesverbal me numër C.nr.197/17 dt.13.12.2021 me të cilin është marrë vendim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, Aktvendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm si dhe shpallja dt.13.12.2022, e të njëjtës datë të përkthyer në Gjuhën angleze nga përkthyesi gjyqësor A. G., dhe në gjuhën serbe nga përkthyesi gjyqësor A. Ç., njoftimi i Gazetës Zyrtare për publikimin e aktvendimit C.nr.197/17 dt.11.01.2023, Përgjigje në padi nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit dt.16.01.2023, Procesverbali i dt.22.02.2023, Parashtrësë e paditëses dt.08.03.2023, Aktvendim C.nr.197/18 për nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit dt.13.03.2023, Lista e transfereve dt.22.03.2023 për pagesën e shpenzimeve në llogarinë e ekspertit të komunikacionit dt.22.03.2023, Ekspertiza e komunikacionit e dt.24.11.2023 e hartuar nga eksperti Faton Bunjaku.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Pas deklarimit të palëve ndërgjygjëse thënieve në padi dhe përgjigjes në padi, deklarimit në seanca, vlerësimit të provave në shkresat e lëndës si dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve – LMD-së (i cili në rastin konkret gjen zbatim), pasi që pala e paditur është thirrur në parashkrim të kërkesëpadiisë duke kontestuar kështu bazën juridike, gjykata i vlerësoj pretendimet e palës paditëse dhe kundërshtimet e të paditurit dhe erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së saj për këto arsye:

Me nenin 357 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), në paragrafin 1 është përcaktuar se: *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”*

Me dispozitën e nenit 362 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve për kërkesat e natyrës së tillë është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *“Kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet.”*, kurse me paragrafin 4 është paraparë se: *“Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguruesit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, **respektivisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin.**”*

Tek këtu paditësja në procedurë administrative është paraqitur kërkesa nga palët e dëmtuara për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e dt.28.01.2017, e cila si organ kompetent me qëllim përcaktimi të kërkesës së të dëmtuarve ka zhvilluar procedurën e kompensimit të dëmit ndaj të dëmtuarve F. A. dhe F. B..

Lidhur me këtë pala paditëse ka marrë vendim ku ka aprovuar kërkesat e palëve të dëmtuara, për kompensimin e dëmit material dhe jo material të pësuar në aksidentin e dt.28.01.2017, për çka

kanë lidhur dhe Pajtim Jashtëgjyqësor, në shumën prej 805.00 € dhe 646.50 €, e në shumë të tërësishme të këtyre kërkesave prej 1,451.50 Euro, shumë kjo e cila ju është paguar të dëmtuarve me datën 29.09.2017 dhe 17.08.2017 në llogarinë e të autorizuarit të të dëmtuarve apo vetë të dëmtuarve, siç shihet nga provat transferi – pagesa e dëmit kontoja të datave të cekura.

Gjykata vlerëson se paditësja që nga ky moment dt.29.09.2017 dhe 17.08.2017 (kur iu është bërë pagesa të dëmtuarve) konform dispozitës së nenit 362 paragrafi 4 i LMD-së, ka fituar të drejtën që të kërkoj rimbursimin e dëmit të kompensuar të dëmtuarve nga këtu i padituri, si dhe konform dispozitave të nenit 14 par.3 me të cilin përcaktohet se: “*Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.*”, lidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën par.1.3. të Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, e për rrjedhojë të kësaj edhe rrjedhja e afatit të parashkrimit të drejtës për rimbursim dëmi fillon të rrjedh nga ky moment, pra nga data e pagesës së kompensimit të dëmit të dëmtuarve datë 29.09.2017 dhe 17.08.2017.

Përndryshe paditësja përderisa nuk ka paguar kurrfarë kompensimi ndaj të dëmtuarve nuk mund dhe të kërkoj rimbursimin e çfarëdo shume të cilën nuk e ka paguar-kompensuar si në këtë rast të dëmtuarve në aksidentin e dt.28.01.2017, siç përcaktojnë dhe dispozitat e cituara.

Gjykata vlerëson se në bazë të lartcekurave nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës se paditësit. Padia është e paraqitur në gjykatë me datë 23.04.2018, kurse pagesa e kompensimit të dëmit të dëmtuarve të pësuar në aksidentin e datës 28.01.2017, është bërë me datën 29.09.2017 dhe 17.08.2017, që në këtë rast padia është paraqitur brenda afatit ligjor prej 3 viteve konform dispozitave të cituara të LMD-së, pas pagesës së dëmit të dëmtuarve, kur paditësja ka kuptuar për shumën e paguar për të cilën dhe ka fituar të drejtën e rimbursimit nga këtu i padituri në bazë të dispozitës së lart cituara të LSDA-së, atëherë për paditësin nuk kemi parashkrim të kërkesëpadiës.

Meqenëse, përveç kësaj ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiësë edhe për sa i përket shkaktarit dhe kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit, gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses me qëllim të eliminimit të dilemave dhe vërtetimit të shkaktarit të aksidentit dhe kontributit të pjesëmarrësve në aksident nxori provën me ekspertizën e komunikacionit e hartuar nga ana e ekspertit gjyqësor Ing. F. B., ekspert i komunikacionit të dt.19.11.2023, në bazë së cilës gjykata vërtetoi bazën juridike të kërkesëpadiësë për faktin se eksperti në mendimin dhe konstatimin e tij, në bazë të materialit të dhënë në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se duke i analizuar të gjitha rrethanat jap mendimin tim profesional se deri tek aksidenti ka ardhur nga lëshimet e drejtuesit të Automjetit “A” z. L.(T.) K., me veprimet e tij:

- *Lëshimi në këtë aksident ishte i ngasësit të automjetit A i cili ishte duke lëvizur me shpejtësi minimale e prej 75.42 km/h në zone të kufizuara prej 40 km/h, dhe i njëjti ishte duke lëvizur në shiritin e kahjes së kundërt të rrugës dhe si pasojë e këtyre veprimeve shoferi i automjetit “A” ishte shkaktar i vetëm i aksidentit të komunikacionit rrugor.*

Gjykata konstatimit dhe mendimit të ekspertit ia dha besimin e plotë dhe e miratoj në tërësi ekspertizën e kryer, meqë e njëjta është e mbështetur dhe argumentuar me prova e cila ka elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale e shkencore për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore.

Nga prova raporti policor nr. 2017-AR-0217 të dt.28.01.2017, skicës së vendit të ngjarjes, gjykata vërtetoi se i padituri ka qenë pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit i cili në atë moment ishte duke drejtuar automjetin e tij pa patentë shofer.

Nga prova transferi i mjeteve në Bankën Ekonomike të dt.29.09.2017, gjykata vërtetoi faktin se të dëmtuarit F. B., i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 805.00 Euro, në llogarinë e përfaqësuesit të tij av. B. A..

Nga urdhërtransferi nr. 17/TPL/PRIS/00159/V-01 të dt. 21.04.2017, gjykata vërtetoi faktin se për të dëmtuarin F. B., është kërkuar nga Departamenti i Financave që të bëhet urdhëresa për transferin e shumës prej 805.00 Euro, sipas afatit të paraparë në ujudi e cila duhet të paguhet në emër të zhdëmtimit.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore nr. 179/17 të dt.28.01.2017, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe palës së dëmtuar F. B., është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt.28.01.2017, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 805.00 Euro.

Nga prova transferi i mjeteve në Bankën Ekonomike të datës 17.08.2017, gjykata vërtetoi faktin se të dëmtuarit F. A., i është bërë pagesa e mjeteve në emër të zhdëmtimit në shumën prej 646.50 Euro, në llogarinë e të autorizuarit të tij Av. B. A..

Nga urdhërtransferi nr. 17/TPL/PRIS/00159/H302 të dt. 27.04.2017, gjykata vërtetoi faktin se për të dëmtuarin F. A., është kërkuar nga Departamenti i Financave që të bëhet urdhëresa për transferin e shumës prej 646.50.00 Euro, sipas afatit të paraparë në ujudi e cila duhet të paguhet në emër të zhdëmtimit.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore e dt. 27.04.2017, vërtetohet fakti se në mes palës paditëse dhe palës së dëmtuar F. A., është arritur marrëveshja për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e trafikut të dt. 28.01.2017, sipas së cilës të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit duhet ti paguhet shuma e përgjithshme prej 431.50 Euro si dhe shpenzimet e avokatit ne shume prej 215.00 € totali 646.50 €.

Gjykata duke vlerësuar provat, deklaramit të paditëses në padi dhe seancë, si dhe deklarimeve të të paditurit në të përgjigjur në padi gjatë shqyrtimit gjyqësor, vlerësoi se paditësja ka të drejtë në rimbursimin e dëmit nga i padituri dhe se ai nuk ka bërë përpjekjen më të vogël ta kompensoi atë apo ta kundërshtoi me prova në procedurë, duke mos ofruar kurrfarë provash që të argumentonte të kundërtën e asaj çka pretendon pala paditëse dhe se provat e ofruara nga pala paditëse e bindën gjykatën se vërtetë ajo ka të drejtë në thëniet e saja dhe se kërkesëpadija e saj është e bazuar, duke i bërë të besueshme pretendimet.

Përkundër kësaj gjendje faktike të vërtetuar në procedurën me prova i padituri nuk e ka bërë rimbursimin e dëmit dhe për shkak të mos rimbursimit të dëmit, ka hyrë në raporte detyrimore

me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse i paditurit e ka cilësinë e debitorit.

Sipas dispozitave të nenit 8 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është përcaktuar se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*

Me dispozitat e nenit 245 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”*

Meqë në rastin konkret u vërtetua se i padituri ka mbetur në borxh ndaj paditëses, e i cili borxh u vërtetua se konsiston në shumën prej 1,451.50 Euro. Pasi që të dëmtuarve iu është bërë pagesa e dëmit të pësuar në aksident trafikun të shkaktuar nga i padituri, i padituri nuk i ka kthyer respektivisht nuk ka bërë rimbursimin e dëmit në shumën e kërkuar. Atëherë, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartcekura në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurin që paditëses t’ia kompensojë dëmin konform dhe dispozitave të nenit 14 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 me të cilin përcaktohet se: *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur:, 1.2 drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimin;”,* ndërsa paragrafi 3 përcakton se: *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”*, lidhur me nenin 13, si dhe neneve 29 par.1 dhe 6, nenit 32 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në emër të rimbursimit të dëmit këtë shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi edhe provat tjera për palën e dëmtuar dhe raportet si dhe provat tjera të administruara që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar ndryshe të çështjes së ngritur me padi, nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën që e njëjta të paguhet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi i është llogaritur konform nenit 382 të LMD-së, por iu refuzua kërkesa e palës paditëse që kamata të jetë nga dita e ngritjes së padisë si e pabazuar sepse i padituri me ditën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e ka kuptuar për dëmin e shkaktuar dhe lartësinë e tij.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u mor konform dispozitave të nenit 449.1, 452 dhe 453.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore - LPK-së, dhe Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke obliguar të paditurin që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi në shumë prej 31.00 Euro, për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 150 Euro, shpenzimet për përkthimin e aktvendimit në shumë prej 50.00 Euro, për pjesëmarrje në tri

seanca gjyqësore shuma nga 135.00 Euro, gjithsejtë shuma prej 405€, si dhe shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm dhe atë për përgjigje në padi 104€, për përfaqësim në seancë nga 135€, shuma prej 270€, e në shumë të përgjithshme prej 374.00 Euro, gjithsejtë shuma e aprovuar prej 1,010 Eurove.

Ndërsa ju refuzua kërkesa paditëses për pagesën e shpenzimeve në emër të përpilimit të padisë prej 104€, si e pabazuar, nga fakti se e njëjta nuk është përpiluar nga avokati i autorizuar, por e njëjta është përpiluar nga zyrtari-juristi i punësuar tek paditësja dhe për këtë nuk është paraparë kompensimi sipas tarifës së OAK-së dhe si e tillë nuk i takon kompensimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.197/2018, me datën 03.01.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.